

## 4.3 AUTOLIVELLANT

### TECNOFLOOR 30



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes	54 cp/paletë	1.5kg/m <sup>2</sup> /mm	Gri



#### TECNOFLOOR 30

Autonivelant me përmbajtje të lartë çimento dhe aditivësh të modifikuar.

#### PËRSHKRIMI

TECNOFLOOR 30 është një autonivelant me bazë çimento dhe aditivë të modifikuar i cili përdoret për shtrim dhe nivelim dyshemesh. Është i klasifikuar si CT - C40 - F10 - AR2 në bazë të stadardit EN 13813.

#### FUSHA E APLIKIMIT

- Përdoret për përgatitjen e sipërfaqeve të lëmuara ose shtresave përpara vendosjes së materialeve si pllaka qeramike, parkete etj.
- Gjithashtu përdoret si shtresë e fundit për themele, magazina, pafango, etj.

#### MËNYRA E PËRGATITJES

##### 1. Përgatitja e suportit

Suporti duhet të jetë i pastër, pa praninë e pluhurave, pjesëve tëshkëputura, vajrave, verniqeve, etj. Fillimisht, sipërfaqja trajtohet me një astar akrilik HYDROPRIMER. Produkti TECNOFLOOR 30 aplikohet mbas tharjes së plotë, afërsisht mbas dy orësh mbas aplikimit të HYDROPRIMER.

Konsumimi i astarit: 200 - 300 g/m<sup>2</sup>.

##### 2. Mënyra e aplikimit

TECNOFLOOR 30 shtohet gradualisht në një sasi uji rreth 6,0 - 6,5L nën një përzierje të vazhdueshme deri sa të formohet një masë homogjene dhe e rrjedhshme. Përzierja lihet 3 minuta në qetesi dhe më pas përzierhet përsëri. TECNOFLOOR 30 hidhet në një shtresë të vetme në sipërfaqen e paratrajtuar me astar deri sa të arrihet trashësia e dëshiruar. Sapo produkti të jetë niveluar kalohet me një rrul me dhëmbëza në mënyrë që të nxjerrë ajrin brenda masës së formuar. Temperatura e aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

#### KONSUMI

Afërsisht. 1,65 Kg/m<sup>2</sup> për mm trashësi shtresë.

#### PAKETIMI

TECNOFLOOR 30 është i ambalazhuar në thasë 25 Kg.

#### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketim origjinal dhe të pahapur. Duhet të mbrohet nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell dhe nga ngrica.



**TË DHËNA TEKNIKE**

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Sasia e ujit për hidratim	5,5–6,0 l /25 kg bag
Pesha volumore e produktit pluhur	1,40 ± 0,10 kg/l
Pesha vëllimore e llaçit të freskët	2,10 ± 0,20 kg/l
Forca shtypëse	40,00 ± 3,50 N/mm <sup>2</sup>
Forca në përkulje	10,00 ± 1,00 N/mm <sup>2</sup>
Forca ngjitëse	>2,0 N/mm <sup>2</sup>
Tkurshmëria	0,29 ± 0,10 mm/m
Jetëgjatësia e produktit të hidratuar	45-60 min at +20°C

